

VENDIM
Nr. 3, datë 16.3.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BORDIT TË TRANSPARENCËS DHE
KUFIZIMIT TË PËRKOHSHËM TË ÇMIMEVE TË TREGTIMIT ME
SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT**

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të nenit 21/3, të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”, të ndryshuar;

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Ngarkohet Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, si dhe Sekretariati i Bordit, të marrë masa për zbatimin e tij.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Qendrën e Botimeve Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Znj. Delina Ibrahimaj	kryetar;
Znj. Belinda Balluku	anëtar;
Z. Ceno Klosi	anëtar;
Z. Genti Gazheli	anëtar;
Z. Niko Lera	anëtar;
Z. Ilia Gjermani	anëtar;
Z. Enea Karakaçi	anëtar;
Z. Sezar Beqaj	anëtar;
Z. Artur Llogoni	anëtar;
Z. Gerian Kuqi	anëtar;
Z. Agron Bulku	anëtar;
Z. Saimir Krasniqi	anëtar.